



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 21 tetor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 39(13) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe neneve 36(1) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”),<sup>2</sup> nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIME

1. Më 8 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjatë konferencës së katërmbëdhjetë mbi ecurinë e çështjes, ftoi ekipet e Mbrojtjes që deri më 7 tetor 2022, të paraqisnin njoftime për mundësi hetimore në bazë të rregullës 99 Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), dhe urdhëroi që kërkesat që justifikonin nevojën për këto masa të dorëzoheshin deri më 28 tetor 2022 (“Kërkesa për Mundësi Hetimore Unike”).<sup>3</sup>

2. Më 7 tetor 2022, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi njoftimin për synimin e saj për të bërë kërkesë për mundësi hetimore unike në bazë të rregullës 99 të Rregullores, ose në alternativë, për të kërkuar marrjen e deponimeve në pajtim me rregullën 100 të Rregullores.<sup>4</sup>

3. Më 20 tetor 2022, Mbrojtja e Thaçit kërkoi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të autorizonte shtimin e numrit të lejuar të fjalëve nga 6000 në 9000 fjalë për Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike (“Kërkesa”).<sup>5</sup> Mbrojtja e Thaçit parashtron

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BD-15, Udhëzues i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1582, rreshti 21 deri në f. 1583, rreshti 6.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F01018, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Mundësitë Hetimore Unike*, 7 tetor 2022, publik, para. 5-6, 15.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F01045, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 20 tetor 2022, publik, para. 1, 11.

se ekzistojnë arsye të vlefshme për shtimin e kërkuar me 3000 fjalë për shkak të: (i) rëndësisë së lëndës, konkretisht nevojës për të paraqitur arsye për kërkesën për ruajtjen e provave të nëntë dëshmitarëve kyç të cilat mund të mos jenë të disponueshme gjatë gjykimit, përfshirë informacione të hollësishme për secilin dëshmitar dhe pyetjet që propozohen t'i bëhen nga pala thirrëse gjatë gjykimit; dhe (ii) hollësive që kërkon Rregullorja për një kërkesë të tillë.<sup>6</sup>

4. Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk iu përgjigj Kërkesës.

## II. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, mocionet për Dhomat e Specializuara nuk duhet të kenë më shumë se 6000 fjalë.

6. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës mund t'i kërkojë leje panelit mjaftueshmërisht në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, duke dhënë arsye të vlefshme për nevojën e tejkalimit të numrit të lejuar të fjalëve.

## III. DISKUTIM

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është dorëzuar në kohë të mjaftueshme para afatit, pasi Kërkesa për Mundësi Hetimore Unike duhet dorëzuar deri më 28 tetor 2022.

8. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh arsyet e paraqitura nga Mbrojtja e Thaçit, veçanërisht: (i) hollësitë që duhet të përfshijë Mbrojtja në Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike në mënyrë që të përliqë kërkesën; dhe (ii) kërkesa lidhet me nëntë dëshmitarë të ndryshëm, për secilin prej të cilëve duhet jepen arsyet për të përliqur kërkesën.

---

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 2, 7-10, që u referohen kritereve të rregullave 99 dhe 100 të Rregullores.

9. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh se shtimi i numrit të lejuar të fjalëve do të mundësonte parashtrimin e një Kërkesë për Mundësi Hetimore Unike më të plotë e më të qartë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se miratimi i shtimit të numrit të lejuar të fjalëve nuk i shkakton asnjë dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave.

10. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se janë treguar arsye të vlefshme që përlligjin shtimin e numrit të lejuar të fjalëve dhe shton deri në 9000 fjalë numrin e lejuar të fjalëve për Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike. Meqë ekipet e tjera të Mbrojtjes bënë më dije se nuk synojnë të kërkojnë mundësi hetimore unike,<sup>7</sup> shtimi përkues i numrit të fjalëve për to nuk është i nevojshëm.

#### IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartcekura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

**MIRATON** Kërkesën dhe shton numrin e lejuar të fjalëve për Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike deri në 9000 fjalë.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E premte, 21 tetor 2022

Në Hagë, Holandë.

---

<sup>7</sup> *Shih* KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1557, rreshtat 2 deri 12; F01012, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mbrojtjes së Veselit lidhur me Mundësitë Hetimore Unike*, 6 tetor 2022, publik, para. 1.